



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 1119 Prot.

Durrës, më 4 . 7 . 2023

VENDIM

Nr. 34 , datë 4 . 7 . 2023

"Mbi ngritjen e Komisionit të Përhershëm për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës"

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", neni 46, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 "*Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës*", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*", të Statutit të UAMD-së, neni 15, pika q, dhe neni 23, pika 5, për të siguruar një nivel cilësor në mbarëvajtjen e marrëdhënies së ngushtë midis studentit, organeve drejtuese dhe strukturave të tjera të UAMD-së, të Rregullores së UAMD-së, të Relacionit nr. 1058 prot, date 21.06.2023 "*Mbi ngritjen e Komisionit të Përhershëm, në nivel Institucional, për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët në UAMD*", Senati Akademik :

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit të Përhershëm për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët në Universitetin "Aleksandër Moisiu".
2. Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 3 (tre) pedagogë me kohë të plotë, kandidatë nga të gjitha Njësitë Kryesore, dhe 2 (dy) studentë. Anëtarët përzgjidhen për një mandat 2-vjeçar, me të drejtë rizgjedhje.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi:
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Kseanela SOTIROESKI

